

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Lazarati te Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/nga-lazarati-te-kanadaja-si-po-ndryshon-trafikimi-i-kanabisit-ne-shqi-i104767
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:33:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:25:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	146d0ab2bc73328b894cd2beffe536b2df55c3b4f246c4b50a84f5a4bf4c4fb8
TEKSTI	a702cd06a8e36502c47e5f1dceb2355668a77161d0c066d1be20b52dbe35e8ff
PAMJA	e2890485ede43d2f2d3feed56ae650e89e55443a793d99151fc1b68dd7176cdb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ec77a817856256f38a7ecf6b2ec5e83bcfbd6d48aae365d934275f9fc69f2f99
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ec77a817856256f38a7ecf6b2ec5e83bcfbd6d48aae365d934275f9fc69f2f99>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

dhe euro, blihet sot me 79.4 lekë dhe

trafikimi i kanabisit

kyesore të kanabisit që trafikohej

e magjistratëve

PS-së për pagat e magjistratëve.

izoluara në

parashikohet i kthjellët si dhe vranësira

e sigurisë

strategjike të naftës në pronësi të shtetit

të mu

AKTUALITET

Nga Lazarati te Kanadaja: Si po ndryshon trafikimi i kanabisit në Shqipëri

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 08:25



Një dekadë më parë, Europol e konsideronte Shqipërinë një prej burimeve kryesore të kanabisit që trafikohej drejt vendeve të BE-së. Lazarati, një fshat pranë Gjirokastrës, në jug të Shqipërisë, i njohur për kultivimin masiv të kanabisit deri në ndërhyrjen policore të vitit 2014, ishte etiketuar gjerësisht në mediat ndërkombëtare si “kryeqyteti evropian i kanabisit”.

Tashmë, Shqipëria nuk është vetëm një vend kultivues dhe eksportues i bimës narkotike. Brenda vetëm 19 ditësh, nga 22 gushti deri më 9 shtator, Policia e Shtetit sekuestroi tre ngarkesa me 233.7 kilogramë kanabis të nisura nga Kanadaja.

Dy prej ngarkesave, me një peshë të kombinuar prej 187.7 kilogramësh dhe vlerë tregu rreth 2.2 milionë euro, mbërritën me kontejnerë në Portin e Durrësit, ku automjete të blera në Kanada dyshohet se u përdorën për fshehjen e drogës. Një ngarkesë tjetër prej 46 kilogramësh u kap në aeroportin e Rinasit, e fshehur në valixhe.

Sekuestrimet në Shqipëri janë pjesë e një prirjeje më të gjerë në tregun evropian të drogës.

Agjencia e Bashkimit Europian për Drogat, EUDA, ka paralajmëruar për rritjen e sasive të kanabisit bimor që trafikohen drejt Europës nga Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara. Sipas agjencisë, kjo prirje lidhet me mbiprodhimin, konkurrencën dhe çmimet më të ulëta në tregun e Amerikës së Veriut.

Kanadaja legalizoi prodhimin, shitjen dhe përdorimin e kanabisit për të rriturit në vitin 2018, por eksportimi i tij jashtë kanaleve të autorizuara mbetet i paligjshëm.

Kanabisi ka vijuar të zërë peshën kryesore në sekuestrimet e lëndëve narkotike në Shqipëri gjatë vitit 2026. Sipas bilanceve mujore të Policisë së Shtetit, përveç rasteve të importit nga Kanadaja, vetëm në katër muajt e parë të vitit u sekuestruan mbi 736 kilogramë kanabis – rreth 186 kg në janar, 490 kg në shkurt, mbi 50 kg në mars dhe rreth 10 kg në prill.

Dy ngarkesat e kapura në Durrës më 22 gusht dhe 9 shtator përbanin në total 187.7 kilogramë *Cannabis sativa*, të llojit që në treg njihet si “Gelato”, për shkak të përqindjes së lartë të substancës psikoaktive tetrahidrokanabinol, THC.

Përmbajtja e lartë e THC-së e bën këtë lloj kanabisi më të fortë dhe, për rrjedhojë, më të kushtueshëm në tregun ilegal.

Sipas Policisë së Shtetit, dy sasitë e sekuestruara në Durrës do të arrinin së bashku një vlerë tregu prej rreth 2.2 milionë eurosh.

Një burim nga Prokuroria e Durrësit i tha BIRN-it, në kushtet e anonimitatit, se ky lloj kanabisi kultivohet zakonisht në ambiente të mbyllura, në të ashtuquajturat “shtëpi bari”, ku kushtet e

kultivimit muna te kontroionen per te rritur perqendrimin e THC-se.

Sipas të njëjtit burim, në rastin e ngarkesës së parë automjeti ishte blerë në Kanada dhe kishte si destinacion përfundimtar Kosovën. Nga hetimet rezultoi gjithashtu se shitësi dhe blerësi i deklaruar i automjetit ishin i njëjti person, me shtetësi kosovare dhe kanadeze.

Më 22 gusht, Policia e Shtetit njoftoi sekuestrimin e rreth 80 kilogramëve kanabis, me një vlerë tregu të përlogaritur në rreth 1 milion euro. Tre shtetas të Kosovës u arrestuan, ndërsa dy persona të tjerë – një nga Kukësi dhe një shtetas kosovar me banim në Kanada – u shpallën në kërkim.

Sipas policisë, droga ishte siguruar në Ontario dhe ishte transportuar drejt Shqipërisë e fshehur në një hapësirë të modifikuar posaçërisht në një automjet të porositur në Kanada.

Kanabisi ishte ndarë në 127 pako, ndërsa automjeti ishte transportuar drejt Shqipërisë brenda një kontejneri detar.

Hetuesit dyshojnë se personat e përfshirë kishin role të përcaktuara në sigurimin, fshehjen, transportimin dhe më pas shpërndarjen e kanabisit nga Kanadaja drejt Shqipërisë dhe Kosovës.

Gjashtë ditë më vonë, më 28 gusht, një tjetër ngarkesë kanabisi nga Kanadaja u kap këtë herë në aeroportin e Rinasit. Policia dhe autoritetet doganore gjetën 89 pako me rreth 46 kilogramë *Cannabis sativa*, të fshehura në dy valixhe, me një vlerë tregu të përlogaritur në rreth 250 mijë euro.

Në operacionin e koduar “Suitcases”, policia arrestoi një 34-vjeçar dhe procedoi penalisht dy gra. Sipas Policisë së Shtetit, hetimet po zhvillohen me metoda speciale për të identifikuar persona të tjerë që mund të jenë përfshirë në trafik.

Më 9 shtator, një ngarkesë e tretë prej 107.7 kilogramësh kanabis “Gelato” u sekuestrua në Portin e Durrësit. Policia e përlogariti vlerën e saj në rreth 1.2 milionë euro.

Ngarkesa u zbulua gjatë kontrollit të një kontejneri të ardhur nga Kanadaja, brenda të cilit ndodheshin dy automjete dhe një kamper.

Në hapësira të modifikuara të kamperit, të mbuluara me veshje druri, policia gjeti 190 pako kanabis. Gjithashtu u sekuestruan 43 cigare elektronike, disa prej të cilave mbanin etiketa që deklaroinin përmbajtje të lartë THC.

Dy persona u shpallën në kërkim.

Policia tha se edhe në këtë rast droga dyshohej se ishte siguruar në Kanada dhe më pas ishte fshehur në automjete të blera atje për t’u transportuar drejt Shqipërisë.

Hetimet vijnë për të identifikuar personat e tjerë të përfshirë dhe për të përcaktuar destinacionin përfundimtar të ngarkesës.

Një korridor i ri drejt Europës

Rastet e Shqipërisë janë të vogla krahasuar me sasitë e kanabisit kanadez që po kapen në portet kryesore të Europës.

Sipas [Agjencisë së Bashkimit European për Drogat, EUDA](#), gjatë vitit 2025 autoritetet sekuestruan rreth 21 tonë kanabis bimor në Portin e Antverpit dhe po aq në Rotterdam, ku ngarkesat vinin kryesisht nga Kanadaja. Autoritetet belge raportuan se vetëm në Antverp sasia e marihuanës së sekuestruar u rrit pothuajse pesëfish krahasuar me një vit më parë.

Përmasat e trafikut u bënë edhe më të dukshme në maj të këtij viti, kur autoritetet britanike [zbuluan 12 tonë](#) kanabis të fshehur në dy kontejnerë të nisur nga Kanadaja dhe të mbërritur në Portin e Southampton-it. Border Force e cilësoi ngarkesën si sekuestrimin më të madh të kanabisit të kryer ndonjëherë nga kjo agjenci, me një vlerë të përlogaritur prej 139 milionë paundësh në tregun ilegal.

Edhe autoritetet kanadeze kanë shtuar kontrollat ndaj ngarkesave që dalin nga vendi. Në shtator 2025, shërbimi kufitar kanadez, CBSA, [sekuestroi në Montreal](#) 2.7 tonë kanabis në dy ngarkesa detare me destinacion Britaninë e Madhe. Njëra prej tyre, prej 2.55 tonësh, ishte fshehur mes pakove me lëndë drusore.

Vetëm gjatë dy muajve të parë të vitit 2026, CBSA dhe Policia Mbretërore Kanadeze, RCMP, [kapën më shumë se një ton kanabis](#) që po largohej nga zona e Torontos. Mes ngarkesave të zbuluara ishin 224 kilogramë me destinacion Gjermaninë dhe 7 kilogramë drejt Holandës, si dhe dy ngarkesa ajrore prej 72 dhe 61.5 kilogramësh drejt Britanisë së Madhe.

Autoritetet kanadeze e lidhin kontrabandën e kanabisit me rrjetet e krimit të organizuar ndërkombëtar. CBSA paralajmëron se të ardhurat nga shitja e tij përdoren për të financuar aktivitete të tjera kriminale, përfshirë trafikimin e narkotikëve dhe armëve.

Rritja e ngarkesave ka sjellë edhe një bashkëpunim më të ngushtë mes dy anëve të Atlantikut. Në qershor, autoritetet doganore të Kanadasë, Holandës, Belgjikës dhe Francës nënshkruan një [marrëveshje për shkëmbim informacioni](#) dhe operacione të përbashkëta kundër trafikut ndërkombëtar të drogës.

Presidentja e CBSA-së, Erin O’Gorman, tha se rrjetet kriminale po bëhen më të afta në shfrytëzimin e korridoreve mes Kanadasë dhe Europës, ndërsa drejtuesit e doganave europiane e cilësuan rritjen e ngarkesave të kanabisit drejt BE-së si një prej arsyeve kryesore për forcimin e bashkëpunimit me Otavën.

Për autoritetet europiane, sekuestrimet e viteve të fundit tregojnë se harta tradicionale e furnizimit me kanabis po ndryshon. Përveç prodhimit brenda Europës dhe rrugëve të vjetra nga Afrika e Veriut dhe Ballkani, portet europiane po përballen gjithnjë e më shumë me ngarkesa të mëdha që kalojnë Atlantikun në kontejnerë tregtarë – një metodë e përdorur edhe në dy rastet e zbuluara në Portin e Durrësit./ BIRN

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 18 Shtator07:46

[Historiana Enriketa Papa: dokumentet tregojnë se filmat në Shqipëri nisën para inaugurimit të Kinostudios](#)

Pedagogia e njohur e historisë, Enriketa Papa, ka sjellë në vëmendje një fakt pak të njohur mbi historinë e kinematografisë...

AKTUALITET 18 Shtator07:33

[Moti sot/ Kthjellime dhe vranësira të pakta, reshje të izoluar në mesditë](#)

Sot vendi ynë do të ndikohet nga kushte atmosferike të qëndrueshme. Moti parashikohet i kthjellët si dhe vranësira të pakt...

AKTUALITET 18 Shtator07:16

[“Taksë e fshehtë” mbi naftën për rezervën e sigurisë, do të rritet çmimi, e pranon dhe qeveria](#)

Qeveria propozoi të krijojë rezervën strategjike të naftës në pronësi të shtetit shqiptar, por një pjesë e k...

AKTUALITET 17 Shtator22:28

[VIDEO nga momenti i sherrit masiv me grushte, karrige dhe thika në Sarandë](#)

Dalin pamjet nga sherrri i ndodhur në Sarandë, mes të rinjve. Siç shihet nga video, të rinjtë përplasen mes tyre me grushte ...

AKTUALITET 17 Shtator21:55

[Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jetën nga aksidenti tragjik në Athinë](#)

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator21:53

[Reforma territoriale/ Banorët e Divjakës në ditën e 49-të të protestës, thirrje: Divjaka bashki](#)

Protesta në Divjakë ka vijuar për të 49-tën ditë, ndërsa qytetarët kundërshtojnë reformën e propozuar adm...

AKTUALITET 17 Shtator21:43

[Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën jetën tre të rinj. Zbardhet dinamika e ngjarjes së rëndë dhe “roli” i një vajze](#)

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

AKTUALITET 17 Shtator21:29

[“Lironi rrugën!”, Policia ndalon marshimin e protestuesve drejt Parlamentit](#)

Marshimi i qytetarëve në Tiranë është përballur me një bllokim nga forcat e policisë, teksa protestuesit po lëvizni...

AKTUALITET 17 Shtator21:09

[Tragjedi në Athinë, 3 të rinj shqiptarë humbin jetën në aksident](#)

Një tragjedi e rëndë ka tronditur komunitetin shqiptar në Greqi dhe familjet në Fier. Tre shqiptarë kanë humbur jetën n&...

AKTUALITET 17 Shtator20:18

[‘Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë’, denoncimi i elektrikistit të OSHEE: Veglat i blejmë vetë](#)

“Rrezikojmë jetën për 64 mijë lekë në muaj dhe duhet të jemi gjithmonë gati për çdo problem”, sh...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 17 Shtator

[Tensionet te ministria e Brendshme, shoqërohet ...](#)

Vijojnë tensionet para Ministrisë së Brendshme. Një grup protestuesit kanë hedhur letra higjienike në drejtim të policisë&e...

SHOWBIZ 17 Shtator

[Susan Sarandon zbulon pse nuk u martua me Tim R...](#)

Susan Sarandon dhe Tim Robbins kaluan 23 vite së bashku, rritën dy fëmijë dhe për shumë kohë u konsideruan një nga &cc...

AKTUALITET 17 Shtator

[Operacion antidrogë në Korçë, arrestohen 3 të r...](#)


Finalizohet një operacion antidrogë në Korçë, në kuadër të të cilit janë arrestuar tre persona dhe jan&eum...


INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues](#)

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

video





E premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



E premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.